



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

**V E N D I M**

**Nr. 67 datë 1.10.2018**

**PËR**

**“DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 2 DATË 21.02.2008  
“PËR REGJISTRIMIN DHE ADMINISTRIMIN E EMRAVE TË DOMAINEVE NËN  
.AL DHE NËNDOMAINET .GOV.AL, .MIL.AL, .EDU.AL, .COM.AL, .ORG.AL DHE  
.NET.AL” E NDRYSHUAR”.**

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare e Këshillit Drejtues Znj. Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 01.10.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin nr.7 datë 16.02.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi aktin rregullator me ndryshimet, shtesat dhe përmirësimet si vijon:

**Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr.2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar,**

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 8, shkronjat *k* dhe *p*, neni 110, neni 114 dhe neni 115 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr. 9918/2008**);
2. Rregullore nr.2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar;

3. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP, nr.41, datë 04.06.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr.2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar”;
4. Neni 8 i Rregullores së Brendshme “Për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP.

## **K Ë S H I L L I D R E J T U E S :**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të paraqitur nga Grupi i Punës, si më poshtë:

1. Relacioni për “Disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr.2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar”;
2. Projekt Vendimi për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr.2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar”;
3. Rregullore nr.2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar”;
4. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP, nr.41, datë 04.06.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr.2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar”;

dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen e ngritur, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

## **V Ë R E N :**

1. AKEP me VKD nr.41 datë 04.06.2018 ka miratuar disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr.2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”, e ndryshuar.
2. Rregullorja nr.2 datë 21.02.2008 e përditësuar u publikua në faqen zyrtare të internetit të AKEP dhe pas publikimit të saj, nga Regjistruerit e domaineve .al përveç çështjeve të dakordësuara, janë paraqitur edhe disa vërejtje dhe sugjerime në AKEP nëpërmjet ankimeve, shkresave dhe e-maileve.
3. Gjithashtu, gjatë muajve Gusht dhe Shtator 2018 janë zhvilluar takime zyrtare në AKEP, me perfaqësues të regjistruerit: Ederhost sh.p.k, Keminet sh.p.k, Studio Driar dhe Shqiperiacom sh.p.k, ku vlen të theksohet fakti që shumica e shqetësimeve të Regjistruerit për ndryshimet në Rregulloren nr.2 datë 21.02.2008 janë sqaruar dhe kuptuar tashmë prej tyre, por ndërkohë mbeten disa çështje për t’u sqaruar më mirë dhe për tu shtuar dhe ndryshuar në Rregulloren nr.2 datë 21.02.2008, me qëllim përmirësimin e saj.

4. Në vijim të takimeve zyrtare, çështjet e ngritura nga Regjistruesit, përmblihen si më poshtë:
  - i. Hyrja në fuqi e kufizimit të numrit të domaineve të bëhet në mënyrë të shkallëzuar, 1 (një) vit nga data e hyrjes në fuqi të ndryshimeve në rregullore. Ky kufizim synon kalimin e emrave të domaineve tek përdoruesit e tyre. AKEP do të monitorojë përgjatë vitit këtë proces në mënyrë që të sigurohet që kjo periudhë tranzitore po përdoret sipas këtij qëllimi nga regjistruesit.
  - ii. Kjo masë e kufizimit të numrit të domaineve do të veprojë për një periudhë 2 vjeçare nga fillimi i aplikimit të saj. AKEP, në bashkëpunim me regjistruesit, do të çmojë nëse do të jetë e nevojshme mbajtja e kësaj mase në përfundim të kësaj periudhe.
  - iii. Rastet e arsyetura për lejimin e një numri më të madh të domaineve të lejohen nga AKEP. Për këtë të mjaftojë dëshmimi i një lidhje të emrave përkatës me subjektin/veprimtarinë e subjektit që ka regjistruar këtë domain.
  - iv. Kufizimi i numrit të veprojë edhe për domainet që Regjistruesit regjistrojnë në emër të tyre, por jo detyrimi për ti paguar me tarifën e AKEP. Ata mund të regjistrojnë për vete njësoj siç dhe ua japin subjekteve të tjerë.
  - v. Për emrat e markave mund të gjendet një mekanizëm që të mos pengohet plotësisht regjistrimi i emrave të tyre, në rast se poseduesi i markës/emrit nuk dëshiron ta regjistrojë një emër të tillë domaini. Këtë mund ta bëjë Regjistruesi ose AKEP.
  - vi. Regjistruesit të jenë përgjegjës për saktësinë e identifikimit të subjekteve që do të regjistrojnë emrat. AKEP të sqarojë që nuk do të kërkojë që formularë të shtypur apo të skanuar të vijnë në AKEP por do të mjaftohet me të dhënat që regjistruesit hedhin në ndërfaqen web. Njëkohësisht, AKEP do të kontrollojë nëse regjistrarët po e kryejnë me korrektesë identifikimin e subjekteve.
  - vii. Domainet .com.al, .org.al dhe .net.al të mund të regjistrohen edhe nga të huajt, por të vendoset kusht kontakt administrativ në Shqipëri.
5. Bazuar në çështjet e ngritura nga regjistruesit, si dhe të vlerësimit përkatës, grupi i punës ka përgatitur dokumentin final për miratim në Këshillin Drejtues të AKEP, të ndryshimeve në Rregulloren nr.2 datë 21.02.2008 "*Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al*", e ndryshuar.
6. Dokumenti "*Disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 "Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al"*" e ndryshuar", i përgatitur nga Grupi i Punës, pas shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave regjistrarëve, është i drejtë, i bazuar ligjërisht dhe në përputhje me funksionet e AKEP.
7. AKEP, në zbatim të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 "*Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, Rregullores nr. 2 datë 21.02.2008 "*Për*

*regjistrimin dhe administrimin e emrave te domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al*” e ndryshuar, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji, si dhe duke marrë në konsideratë të gjitha kërkesat dhe ankesat e paraqitura në AKEP, nga subjekte të ndryshëm në lidhje me domainet .al dhe nëndomaineve, çmon si të rëndësishme bërjen e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr.2, datë 21.02.2008, e ndryshuar, sipas çështjeve të të ngritura për trajtim.

8. Me ndryshimet e bëra nëpërmjet këtij vendimi, AKEP vazhdon të përmirësojë Rregulloren nr.2 datë 19.05.2008 të ndryshuar.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Këshilli Drejtues i AKEP, duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të këtij vendimi si dhe në zbatim të kompetencës ligjore të përcaktuara në shkronjat k, dhe p të nenit 8, nenit 114 dhe nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

1. Të miratojë dokumentin,
  - “Disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar.
2. Efektet e zbatimit të këtij vendimi, akteve rregullatore të miratura me këtë vendim, fillojnë nga **data 1 Nëntor 2018**.
3. Ky Vendim dhe dokumenti i miratuar në pikën 1 më sipër të publikohen në faqen zyrtare të internetit të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al).
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga data e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të internetit të AKEP.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**KRYETARI**

**Ilir ZELA**

### **ANËTARË:**

1. Alban KARAPICI
2. Edlira DVORANI
3. Ketrin TOPÇIU
4. Klarina ALLUSHI



PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME  
NË RREGULLOREN NR. 2 DATË 21.02.2008

*“Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën .al dhe nën domain-et .gov, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”, e ndryshuar.*

Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 67 datë 10.01.2018  
*Me ngjyre te kuqe paraqiten ndryshimet e aplikuar.*

## 1. Pika 7.1 b), e Rregullores Nr.2:

### Është :

- b) Numri i lejuar i domaineve .al përfshirë nëndomainet, në posedim, është deri në 5 domaine për individët dhe deri 15 domaine për subjektet fizike dhe juridike private/tregtare (përfshirë Regjistruesit e domaineve .al), me kushtin që të vendosen në përdorim brenda një afati 1 (një) vjeçar. Regjistruesit kanë detyrimin të kontrollojnë nëse domaini i regjistruar/modifikuar/transferuar prej tyre, është vendosur në përdorim brenda këtij afati, në të kundërt Regjistruesi njofton elektronikisht AKEP për ta kaluar atë domain në gjendje të lirë. Vendosja në përdorim e një domaini .al nënkupton paraqitjen e provave dhe fakteve siç janë, krijimi i një faqe web me atë domain, përdorimi i emaileve me atë domain, krijimi i rrjeteve të hapura ose të mbyllura me atë domain, aksesimi i sistemeve apo databazeve në distancë, pointimi në faqe web të tjera por me përmbajtje të të njëjtit posedues domaini, përdorime teknike si DNS, FTP, SSH, HTTP/HTTPS, Peer to Peer, etj.

### Ndryshon në:

- b) Numri i lejuar i domaineve .al përfshirë nëndomainet, në posedim, është deri në 5 domaine për individët dhe deri 15 domaine për subjektet fizike dhe juridike private/tregtare (përfshirë Regjistruesit e domaineve .al), me kushtin që të vendosen në përdorim brenda një afati 1 (një) vjeçar. Regjistruesit kanë detyrimin të kontrollojnë nëse domaini i regjistruar/modifikuar/transferuar prej tyre, është vendosur në përdorim brenda këtij afati, në të kundërt Regjistruesi njofton elektronikisht AKEP për ta kaluar atë domain në gjendje të lirë. Vendosja në përdorim e një domaini .al nënkupton paraqitjen e provave dhe fakteve siç janë, krijimi i një faqe web me atë domain, përdorimi i emaileve me atë domain, krijimi i rrjeteve të hapura ose të mbyllura me atë domain, aksesimi i sistemeve apo databazeve në distancë, pointimi në faqe web të tjera por me përmbajtje të të njëjtit posedues domaini, përdorime teknike si DNS, FTP, SSH, HTTP/HTTPS, Peer to Peer, etj.

*Hyrja në fuqi e kufizimit të numrit të domaineve përcaktuar si më sipër, do të bëhet në mënyrë të shkallëzuar, 1 (një) vit nga data e hyrjes në fuqi të ndryshimeve në këtë rregullore. Kjo masë e kufizimit të numrit të domaineve do të veprojë për një periudhë 2 vjeçare nga fillimi i aplikimit të saj. AKEP, në bashkëpunim me regjistruesit, do të çmojë nëse do të jetë e nevojshme mbajtja e kësaj mase në përfundim të kësaj periudhe.*

## 2. Pika 7.1 c) e nenin 7, te Rregullores Nr. 2 :

### Është :

- c) Në rast se për nevoja teknike, tregtare, etj, por të arsyetuara, kërkohet të regjistrohen më shumë domaine .al se numri i përcaktuar në pikën b, regjistrimi i domaineve shtesë bëhet vetëm me miratimin e AKEP, por me kushtin që të vendosen në punë sipas afatit të mësipërm. Të interesuarit mund të drejtojnë këtë lloj kërkesë Regjistruesit të preferuar (ose AKEP nëse ka domaine të regjistruara nëpërmjet AKEP). Regjistruesi e përcjell elektronikisht këtë lloj kërkesë në AKEP brenda 3 ditë pune e cila shqyrtohet dhe i jepet përgjigje brenda afateve dhe përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

## **Ndryshon në:**

*c) Në rast se për nevoja teknike, tregtare, etj, por të arësytuara, kërkohet të regjistrohen më shumë domaine .al se numri i përcaktuar në pikën b, regjistrimi i domaineve shtesë bëhet vetëm me miratimin e AKEP, por me kushtin që të vendosen në punë sipas afatit të mësipërm. **Për këtë do të mjaftojë dëshmimi i një lidhjeje të emrave përkatës me subjektin/veprimtarinë e subjektit që kërkon të regjistrojë këto domaine shtesë.** Të interesuarit mund ti drejtojnë këtë lloj kërkesë Regjistruesit të preferuar (ose AKEP nëse ka domaine të regjistruara nëpërmjet AKEP). Regjistruesi e përcjell elektronikisht këtë lloj kërkesë në AKEP brenda 3 ditë pune e cila shqyrtohet dhe i jepet përgjigje brenda afateve dhe përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative.*

### **3. Ne pikën 19.3 të nenit 19 të Rregullores nr. 2, pas paragrafit të dytë shtohet ky paragraf:**

*Transferimi i një domaini nën “.al”, nuk e ndryshon afatin e tij të vlefshmërisë së atij domain, si rrjedhojë Regjistruesi marrës nuk do të kreditohet për këtë transferim.*

### **4. Pika 19.2 e nenit 19, të Rregullores Nr. 2:**

#### **Është:**

19.2 Emra të rezervuar konsiderohen emrat që janë objekt regjistrimi me kushte të veçanta të lidhura me identitetin dhe kategorinë në të cilën klasifikohet aplikuesi.

*Emrat e markave, patentave dhe dizenjove industriale të miratuara nga institucioni përkatës, të cilat përkohet saktësisht me emër domaini nën “.al”, përbëjnë emra të rezervuar për poseduesit e markës/patentës/dizenjos industriale të regjistruar.*

#### **Ndryshon në:**

19.2 Emra të rezervuar konsiderohen emrat që janë objekt regjistrimi me kushte të veçanta të lidhura me identitetin dhe kategorinë në të cilën klasifikohet aplikuesi.

*Emrat e markave, patentave dhe dizenjove industriale të miratuara nga institucioni përkatës, të cilat përkohet saktësisht me emër domaini nën “.al”, përbëjnë emra të rezervuar për poseduesit e markës/patentës/dizenjos industriale të regjistruar.*

*Përyshirohen rastet kur kërkuesi i një emri domaini nën “.al”, pasi është konsultuar me linkun e faqes web zyrtare me DPPI - seksioni i databazës online të markave/patentave/dizenjove industriale të regjistruara, së bashku me të dhënat e kërkuara të regjistrimit, deklaronte me shkrim që ai pranon të lirojë/heqë dorë për atë domain brenda 30 ditëve nga marrja e tij, duke humbur çdo të drejtë për ankim apo çdo kërkesë për kompensim, nëse emri i të njëjtit domain është kërkuar apo do të kërkohet të posedohet nga poseduesi i ligjshëm i markës/patentës/dizenjos industriale.*

## 5. Pikat a) dhe c) te nenit 4/1 te Rregullores nr. 2:

### Janë:

- a) Afati për regjistrimin e domain .al (dhe nëndomaineve), nga AKEP dhe Regjistruesit, është deri 3 ditë pune nga momenti i paraqitjes së formularit të rregullt të aplikimit. Paraqitja e një formulari jo të plotësuar saktë, nuk ja heq të drejtën për emrin e domainit aplikuesit si dhe asnjë aplikues tjetër nuk ka të drejtë të marrë këtë domain gjatë kohës që aplikuesi i parë riplotëson/korrigjon të dhënat në formularin e parë.
- c) Afati për modifikimin/transferimin/mbylljen e domainit .al (dhe nëndomaineve), nga AKEP dhe Regjistruesit, është 3 ditë pune nga momenti i paraqitjes së formularit të rregullt të aplikimit.

### Ndryshojnë në:

- a) Afati për regjistrimin e domain .al (dhe nëndomaineve), nga AKEP dhe Regjistruesit, është deri 3 ditë pune nga momenti i paraqitjes së të dhënave të plota siç përshkruhen në formularët e kësaj rregullore. Paraqitja e të dhënave jo të plota apo me pasaktësi, nuk ja heq të drejtën për emrin e domainit aplikuesit si dhe asnjë aplikues tjetër nuk ka të drejtë të marrë këtë domain gjatë kohës që aplikuesi i parë riplotëson/korrigjon të dhënat e kërkuara.
- c) Afati për modifikimin/transferimin/mbylljen e domainit .al (dhe nëndomaineve), nga AKEP dhe Regjistruesit, është 3 ditë pune nga momenti i paraqitjes së të dhënave të plota, siç përshkruhen në formularët e kësaj rregulloreje.

## 6. Paragrafi i dyte i pikes 29.3 te nenit 29 te Rregullores nr. 2:

### Është:

Formulari i transferimit i dorëzohet nga poseduesi Regjistruesit marrës, i cili pasi plotëson pjesën e tij të formularit, e dërgon në formë elektronike në AKEP. AKEP kontrollon nëse formulari është plotësuar saktë dhe nëse po, i komunikon në formë elektronike Regjistruesit transferimin ndërsa Regjistruesi marrës njofton menjëherë poseduesin për kryerjen e transferimit. Përpara dërgimit të formularit të transferimit, një komunikim mes Regjistruesit marrës, Regjistruesit dhënës dhe kërkuesit, mund të jetë i nevojshëm të kryhet për të sqaruar nëse janë shlyer detyrimet financiare të mëparshme nga poseduesi i domainit.

### Ndryshon në:

Të dhënat e përshkruara në formularin e transferimit i dorëzohen nga poseduesi Regjistruesit marrës, i cili pasi plotëson pjesën e tij të formularit, e dërgon në formë elektronike në AKEP. AKEP kontrollon nëse të dhënat janë plotësuar saktë dhe nëse po, i komunikon në formë elektronike Regjistruesit transferimin, ndërsa Regjistruesi marrës njofton menjëherë poseduesin për kryerjen e transferimit. Përpara kërkesës për transferim, një komunikim mes Regjistruesit



*marrës, Regjistruesit dhënës dhe kërkuesit, mund të jetë i nevojshëm të kryhet për të sqaruar nëse janë shlyer detyrimet financiare të mëparshme nga poseduesi i domainit.*

## **7. Pika 8.1 e Aneksit 1 te Rregullors nr. 2:**

### **Është:**

*Në rast se poseduesi i domainit nën .al dëshiron të transferojë domainin nga një Regjistrues tek një tjetër Regjistrues, Regjistruesi marrës duhet të plotësojë formularin përkatës të aplikimit së bashku me poseduesin e domainit. Veprimet kryhen sipas përcaktimeve të nenit 29.3 të Rregullores.*

### **Ndryshon në:**

*Në rast se poseduesi i domainit nën .al dëshiron të transferojë domainin nga një Regjistrues tek një tjetër Regjistrues, Regjistruesi marrës duhet të **plotësojë të dhënat siç përshkruhen në formularin përkatës** të aplikimit së bashku me poseduesin e domainit. Veprimet kryhen sipas përcaktimeve të nenit 29.3 të Rregullores.*

## **8. Pika 13.1 b) e nenit 13 te Rregullores nr. 2:**

### **Është:**

b) nën domain “.com.al”, “.org.al” dhe “net.al”, e kanë personat juridik publik dhe privat, si dhe personat fizik tregtarë me rezidencë të aktivitetit tregtarë në Shqipëri, të regjistruar si të tillë sipas legjislacionit në fuqi për këtë qëllim.

### **Ndryshon në:**

b) nën domain “.com.al”, “.org.al” dhe “net.al”, e kanë personat juridik publik dhe privat, si dhe personat fizik tregtarë me seli/objekt të aktivitetit tregtarë në Shqipëri, të regjistruar si të tillë sipas legjislacionit në fuqi për këtë qëllim, **si dhe shtetas të huaj persona juridik publik dhe privat.**